



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 636/16 Prot

Tiranë, më 10/7/2020

VENDIM

Nr. 21, datë 10.7.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. \_\_\_\_\_ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) ankesën nr. 636 Prot., datë 05.06.2020, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, me shkresën nr. 47/20 Prot., të datës 08.05.2020, dërguar nëpërmjet e-mailit në adresën zyrtare të Autoritetit Publik [info@kpk.al](mailto:info@kpk.al), si dhe në adresën e koordinatorit të së drejtës për informim [gentiana.milkani@kpk.al](mailto:gentiana.milkani@kpk.al), ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion dokumentacioni si më poshtë:

1. *Kopje të vendimit të ndërmjetëm nr. 33, datë 27.05.2019, për subjektin e rivlerësimit znj. Hajrie Muçmataj;*
2. *Kopje të vendimit datë 29.10.2019, për rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit znj. Hajrie Muçmataj, për përjashtimin e trupit gjykues.*

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mailit të datës 11.05.2020 ka kthyer përgjigje, duke informuar kërkuuesin se: “...Komisioni nuk disponon vendim me të dhënat e kërkuara (vendimin nr. 33, datë 27.05.2019) për subjektin Hajrije Muçmataj”.



Ankuesi, nëpërmjet e-mailit të datës 15.05.2020, ka saktësuar objektin e kërkesës, derguar Autoritetit Publik, duke sqaruar se vendimi të cilit i referohet, është vendimi që pasqyrohet në pikën 13 të Vendimit nr. 209 datë 11.11.2019 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Hajrie Muçmata.

Gjithashtu, në po këtë e-mail, Qendra “Res Publica”, ka rikujtuar përmbushjen e detyrimit për informim, për një kërkesë të mëparshme drejtuar Autoritetit Publik, me nr. 37/20 Prot., me objekt “Kopje të vendimit datë 04.10.2019, për rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit znj. \_\_\_\_\_, për përjashtimin e relatores, të paanonimizuar.

Në vijim të korrespondencës, Autoriteti Publik me e-mailin e datës 20.05.2020, ka kthyer përgjigje duke argumentuar se: “Në bazë të nenit 28 të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, është detyrimi i anëtarit të institucionit të rivlerësimit dhe personelit të tyre të trajtojnë informacionin për procedurën e rivlerësimit në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Institucionet e rivlerësimit përjashtohen nga ky detyrim, vetëm në rastet kur informacioni i jepet subjektit të rivlerësimit, ose organeve që me ligj kanë të drejtë t’ia kërkojnë këtë informacion për shkak të detyrës zyrtare”.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka publikuar në faqen zyrtare <https://kpk.al/znj-hajrie-mucmata-gjytare-pranë-gjykatës-së-apelit-shkodër/>, arsyetimin e vendimit të ndërmjetëm datë 29.10.2019, vendim ky i cili argumenton rrëzimin e kërkesës së subjektit Hajrie Muçmata, për përjashtimin e trupit gjykues. Bazuar në nenin 28, të ligjit të mësipërm, Komisioni ka vendosur të bëjë publik vetëm informacionin që gjendet në vendimin e themelit, pasi vlerësimi i tij bëhet rast pas rasti. Argumentimi i mësipërm është i vlefshëm edhe për rastin e vendimit të subjektit të rivlerësimit \_\_\_\_\_. Pra, mbetet në vlerësimin e Komisionit.

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, dhe nenin 31/1c të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Komisioneri me Urdhrin nr. 100, datë 12.06.2020, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.



Gjatë inspektimit, koordinatorja e Autoritetit Publik, argumentoi në tërësi refuzimin e dhënies së informacionit, duke i qëndruar argumenteve të parashtruara në shkresën kthim përgjigje, si dhe duke plotësuar argumentin si më poshtë:

*"Lidhur me subjektin e rivlerësimit, për të cilën kërkohet informacion, në datë 11.11.2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Hajrie Muçmata, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër. Ky vendim i'u njoftua subjektit të rivlerësimit, si dhe u publikua në faqen zyrtare të Komisionit [www.kpk.al](http://www.kpk.al), në datën 06.05.2020.*

*Gjithashtu, në zbatim të pikës 7 të nenit 4, të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 1 të nenit A, të Aneksit të saj, si dhe të parimit të proporcionalitetit, Komisioni ka publikuar dhe bërë transparent informacionin e nevojshëm, në faqen e tij zyrtare [www.kpk.al](http://www.kpk.al), lidhur me vendimmarrjen, përfshirë dhe çdo kërkesë procedurale të subjektit Hajrie Muçmata, për të cilën ka disponuar me vendim. Kjo vendimmarrje pasqyrohet edhe në vendimin e arsyetuar me shkrim, në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit. Ligjvënësi ka parashikuar që Komisioni, me qëllim informimin e publikut të publikojë vendimin duke anonimizuar variantin e publikuar zyrtarisht në faqen e internetit të institucionit.*

*Ndërsa, sa i takon dosjes gjyqësore të vendimit të shkarkimit nga detyra të subjektit Hajrie Muçmata, me vendimin nr. 209 datë 11.11.2019 të Komisionit, rezulton se kjo dosje aktualisht ndodhet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili gjykon si shkallë e dytë ankimin e subjektit dhe në bazë të juridiksionit të tij rivlerësues, do të vendosë përfundimisht për të gjitha shkaqet e ankimit dhe të vendimit të dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për këtë subjekt.*

Në vijim, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" (në vijim "Ligji 119/2014"), në të cilin parashikohet se: *"...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", bazuar dhe në nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore ndërmjet palëve.*

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 02.07.2020, në prani të znj. Brunilda Qershori, përfaqësuese e ankuesit nëpërmjet autorizimit të datës 01.07.2020 dhe znj. Gentiana Milkani, përfaqësuese e Autoritetit Publik dhe njëkohësisht koordinator i së drejtës për informim pranë Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, Autoriteti Publik mbajti të njëjtin qëndrim, me atë të mbajtur në përgjigjen e kthyer për kërkuesin në datë 20.06.2020.

Ankuesi e konsideroi arsyetimin e Autoritetit Publik për refuzimin e dhënies së informacionit, të pa mbështetur në ligj duke argumentuar se:



- *Informacioni i kërkuar përbën informacion, i cili bëhet publik pa kërkesë dhe vendimet (objekt i kërkesës për informacion) bëjnë pjesë në këtë kategori informacioni;*
- *autoriteti publik mund të operojë me mbulimin/fshirjen e të dhënave personale por në asnjë rast nuk mund të refuzojë të gjithë informacionin;*
- *nga ana e autoritetit publik nuk është bërë me dije nëse informacioni i kërkuar kufizohet bazuar në nenin 17 të ligjit për të drejtën e informimit;*
- *pika 2 e nenit 17 parashikon se informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij, dhe në këtë proces e drejta e publikut për t'u informuar mbizotëron mbi interesat private të vetë subjektit të rivlerësimit .*
- *Autoriteti Publik ka mbajtur qëndrime të ndryshme, kundrejt dy kërkesave të ngjashme për informacion. Në njërin rast, pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit, ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar duke e anonimizuar. Ndërsa në rastin konkret, ka refuzuar tërësisht dhënien e informacionit me argumentin se “publikimi i informacionit vlerësohet rast pas rasti”.*

Pas administrimit të parashtrimeve të paraqitura nga palët, Komisioneri vlerëson se në rastin konkret ngrihen disa çështje për trajtim, për zgjidhjen e të cilave duhen marrë në konsideratë gjithashtu dispozitat e *lex specialis*, i zbatueshëm për realizimin e procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet:

- “1. Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi.*
- 2. Rivlerësimi do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit.*
- 5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit”.*

Në nenin 2, të Ligjit 119/2014 parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.*

Në kuptim të këtij parashikimi, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është autoritet publik dhe për rrjedhojë, është subjekt i ligjit për të drejtën e informimit.

Në ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji 84/2016”), përcaktohen ndër të tjera parimet e organizimit të procesit të rivlerësimit, procedurat dhe standardet e rivlerësimit, si dhe organizimi dhe funksionimi i institucioneve të rivlerësimit.



Në pikën 2, të nenit 4 të Ligjit 84/2016, parashikohet se: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*.

Ndërkohë, në pikën 7, të nenit 55 të Ligjit 84/2016, parashikohet se: *“Vendimi me shkrim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit”*.

Detyrimi për publikimin e vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit bazohet gjithashtu dhe në pikën 2 të nenit 4 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mbi rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në të cilin parashikohet se: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit publikojnë vendimet e tyre si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm të marrë nga publiku.”*

Komisioneri vlerëson se, Autoritetit Publik e ushtron funksionin e tij publik ndër të tjera, nëpërmjet nxjerrjes së vendimeve.

Legjislacioni i sipërcituar nuk parashikon rregullim të posaçëm për llojet e vendimeve që nxjerr ky autoritet publik, por bazuar në pikën 6, të nenit 4 të Ligjit 84/2016, ku parashikohet se: *“Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji.”*, të gjitha vendimet, përfshirë ato të ndërmjetme, kanë të njëjtat tipare juridike, lidhur me formën dhe përmbajtjen, me vendimin përfundimtar, në mënyrë që të prodhojnë pasoja.

Për rrjedhojë, bazuar në pikën 2, të neni 2 të Ligjit 119/2014 *“Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”*, Komisioneri vlerëson se të gjitha vendimet e Autoritetit Publik, përbëjnë informacion publik dhe bazuar në dispozitat e sipërcituara duhet të publikohen të plota në faqen zyrtare në internet, duke mbajtur në konsideratë kufizimet sipas *lex specialis*, si dhe nenit 17 të ligjit për të drejtën e informimit.

Në lidhje me kufizimet e aplikuara në rastin konkret, Zyra e Komisionerit, duke marrë në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe argumentet e paraqitura nga ana e Autoritetit Publik, vlerëson se ato janë të pabazuara në ligj dhe në prova për arsyet e mëposhtme

Konkretisht, Autoriteti Publik pretendon se: *bazuar në pikën 4, të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” E drejta e informimit kufizohet edhe kur pavarësisht nga ndihma e dhënë nga autoriteti publik, kërkesa mbetet e paqartë dhe i bëhet i pamundur identifikimi i informacionit të kërkuar”*. Komisioneri vlerëson se ky argument është jo vetëm kundërshtues me pretendimet e tjera të ngritura nga ana e



Autoriteti Publik, por edhe i pabazuar referuar materialeve në dosje, inspektimit të kryer, si dhe seancës dëgjimore të zhvilluar. Referuar kërkesës së paraqitur, konstatohet lehtësisht se informacioni që kërkohet nga Ankuesit është i qartë dhe i identifikueshëm.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit ndalimi i publikimit të informacionit të kërkuar, bazohet në pikën 2 të nenit 28 të Ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve”, sipas të cilit “*Anëtari i institucionit të rivlerësimit dhe personeli i tyre trajtojnë informacionin për procedurën e rivlerësimit, në respektim të parimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Institucionet e rivlerësimit përjashtohen nga ky detyrim vetëm në rastet kur informacioni i jepet subjektit të rivlerësimit ose organeve që me ligj kanë të drejtë ta kërkojnë këtë informacion për shkak të detyrës zyrtare*”. Komisioneri vlerëson se ky parashikim nuk gjen zbatim në rastin konkret, pasi rregullon një situatë të ndryshme.

Ruajtja e konfidencialitetit është një parim i përgjithshëm, i materializuar gjithashtu dhe në nenin 8 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, i cili në nenin 28 të tij parashikon se “*Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit.*”.

Për rrjedhojë, pika 2 e nenit 28 më sipër, nuk ka për qëllim të rregullojë kufizimin e publikimit të informacionit publik nga ana e autoriteteve publike, por të normojë sjelljen e nëpunësve të administratës publike, të cilët gjatë ushtrimit të detyrave të tyre kontrollojnë, përpunojnë apo vihen në dijeni të të dhënave personale të subjekteve të tjerë. Pavarësisht sa më sipër, edhe nëse dispozita do të lexohej sipas këndvështrimit të Autoritetit Publik, ky i fundit duhet të kishte mbajtur në konsideratë pikën 6 të nenit 17 të Ligjit 119/2014, sipas së cilës “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”, dhe jo të refuzonte në tërësi pa argumentimin përkatës dhënien e informacionit.

Komisioneri gjen me vend të theksojë se nga vetë rëndësia e procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, qëllimi i të cilit është rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë, garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës dhe pavarësisë së këtij sistemi, legjislatori jo pa qëllim ka parashikuar në pikën 1 të nenit A, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mbi rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, se: “*Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.*”.

Neni 17 i Kushtetutës parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë “*... mund të vendosen me ligj për një interes publik, ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve*”.



Nga sa më sipër, në analizë të të gjithë kuadrit ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit në sistemin e drejtësisë, reflektohet qartë mbizotërimi i interesit publik në raport me interesat e subjekteve të rivlerësimit. Ky qëndrim është mbajtur gjithashtu dhe nga Gjykata Kushtetuese e cila në vendimin e saj nr. 02, datë 18.01.2017, me objekt shqyrtimin e ligjit 84/2016, ka çmuar se: *“Gjykata vëren se ndërhyrja në këtë rast justifikohet me interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret ndërhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNJ-së, si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë”.*

Për sa i përket argumentit tjetër të Autoritetit Publik, se e drejta për informim në rastin konkret kufizohet në përputhje me pikën 7 të nenit 4 të Ligjit 84/2016, *si dhe kufizohet edhe për arsye se dosja e subjektit është dërguar pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili do të vendosë përfundimisht për të gjitha shkaqet e ankimit dhe të vendimit të dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit*, Komisioneri vlerëson se edhe këto argumente nuk qëndrojnë.

Në pikën 7 të nenit 4 të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", parashikohet shprehimisht se:

*“E drejta e informimit, e parashikuar në ligjin “Mbi të drejtën e informimit”, mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit”.*

Komisioneri vlerëson se dispozita e sipërcituar nuk gjen zbatim në rastin konkret, pasi objekt i kërkesës janë dy akte administrative që konsistojnë në vendimmarrjen e autoritetit në kuadër të veprimtarisë funksionale të tij. Dispozita rregullon kufizimin e të drejtës për informim gjatë procesit të rivlerësimit, dhe jo mbasi ky proces ka përfunduar me vendimmarrje, siç është dhe rasti konkret.

Po ashtu, dispozita parashikon detyrimin e autoritetit publik, që në çdo rast duhet të respektohet parimi i proporcionalitetit duke vlerësuar nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit. Referuar argumenteve të parashtruara nga Autoriteti Publik, nuk konstatohet një vlerësim nga ana e këtij të fundit, për sa i përket dëmit të mundshëm si pasojë e dhënies së informacionit të kërkuar.

Në lidhje me këtë argument të Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duhet mbajtur në konsideratë vet qëllimi i Ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" sipas të cilit: *“Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjithë subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës.”.*



E drejta për informimin, ben pjese ne grupin e te drejtave themelore te njeriut, te mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t'i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe për ti shërbyer nxitjes së integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike, duke ndihmuar në rastin konkret në realizimin e qëllimit të procesit të rivlerësimit, për rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit 119/2014.

Në pikën dy të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore”*.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 të ligjit 119/2014 parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri, vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të ankuesit, dokumentacionin sipas kërkesës së datës 08.05.2020.

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni i shqyrtuar dhe përmendur më sipër, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik duhet të ketë në vëmendje nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe pikën 6 të nenit 17 të Ligjit 119/2014.

Ndërkohë në pikën 1 të nenit 18 të ligjit për të drejtën e informimit, parashikohet se mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012



“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

#### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 636 Prot., datë 05.06.2020 të Qendrës “Res Publica”, kundër Autoritetit Publik “Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit të kërkuar, konkretisht:  
- Kopje të vendimit të ndërmjetëm nr. 33, datë 27.05.2019, për subjektin e rivlerësimit znj. Hajrie Muçmata;  
- Kopje të vendimit datë 29.10.2019, për rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit znj. Hajrie Muçmata, për përjashtimin e trupit gjykues, brenda datës 20.7.2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 10.7.2020.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

